



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit

P-088

Prishtinë, më 30 dhjetor 2016

**PROCESVERBAL**

**I SEANCËS SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË  
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 30 DHJETOR 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

Kryetari i hapi punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit.

Kryetari i njoftoi deputetët se kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Isa Mustafa, në mbështetje të nenit 69.4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës ka kërkuar mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L -261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Por, para se të fillojmë me shqyrtimin e këtij projektligjit, Kuvendi duhet të vendosë për shmangie nga afatet procedurale të parapara me dispozitat e Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin e projektligjeve.

Kryetari i GP të PDK-së, z. Zenun Pajaziti, e paraqiti dhe e arsyetoi propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L -261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Kryetari kërkoi deklarinimin e grupeve parlamentare për propozimin e lartshënuar.

Lidhur me propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës diskutuan: Zenun Pajaziti, në emër të GP të PDK-së, Salih Morina, në emër të GP të LDK-së, Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së, Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së, Enver Hoti, në emër të GP “Nisma”, Duda Balje, në emër të GP “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetarit të GP të PDK-së për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 52  
Kundër ----- 9  
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

#### V E N D I M

Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të bëhet me procedurë të përsheptuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1, nenin 57, paragrafët 3, 5, 8 dhe 9 dhe nenin 64 të Rregullores së Kuvendit, dhe atë si në vijim:

1. Shqyrtimi i parë të bëhet në seancën plenare më 30 dhjetor 2016.
2. Pas miratimit në shqyrtim të parë, Komisioni Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe komisionet e përhershme: Komisioni për Buxhet dhe Financa, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim, Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe Komisioni për Integritet Evropian duhet ta shqyrtojnë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime për seancën e re plenare që do të mbahet më 30 dhjetor 2016.
3. Shqyrtimi i dytë i projektligjit të bëhet në seancën e re plenare, më 30 dhjetor 2016.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Pastaj, kryetari procedoi me pikën e rendit të ditës:

#### **1. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës**

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale, z. Arban Abrashi, në emër të sponsoruesit, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ai i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa, e shpjegoi rëndësinë e miratimit të këtij projektligji për të rregulluar pagesat për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe respektimin e rekomandimeve të Fondit Monetar Ndërkombëtar në lidhje me shpenzimet buxhetore për vitin vijues. Diskutimi i plotë i kryeministrit është dhënë në transkript.

Kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, tha se me ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për veteranët e UÇK-së nuk i zgjidhim të gjitha problemet e bashkëluftëtarëve tanë, për arsye se edhe shumë gjëra duhet të qartësohen në Ligjin për veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me këto ndryshime dhe plotësime po shkojmë drejt përmirësimeve hap pas hapi. Eliminohen disa nga mangësitë e ligjit të mëparshëm dhe krijohet bazë ligjore për një trajtim më meritore të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Ajo çfarë është risi në këtë projektligj është insistimi që të ndihmohen veçanërisht bashkëluftëtarët, familjet e atyre që sot nuk i kemi gjallë, do t'u jepet ndihmë këtyre familjeve, përkatësisht fëmijëve të tyre, deri në 250 euro. Janë mbi 800 vetë, të cilët nga 12 qershori 1999 e deri më tash kanë vdekur dhe nuk kanë përkujdesje të duhur institucionale.

Me këtë projektligj ne i riafirmojmë vlerat e luftës sonë çlirimtare, përkushtimin, mundin dhe sakrificën e mijëra burrave dhe grave të Kosovës për liri, pavarësi dhe shtet të pavarur sovran, por nuk do të ndalemi me kaq. Ne kemi edhe kategoritë e martirëve, do të shikojmë edhe për ta mundësinë e përmirësimeve ligjore. Natyrisht, edhe familjet e të pagjeturve, të cilët janë një kategori bukur e madhe dhe nuk dinë fare për fatin e të pagjeturve dhe të njëjtën kohë kanë shpenzuar shumë si familje, në përpjekjet e tyre për të ditur më shumë për zbardhjen e fatit të të dashurve të tyre. Diskutimi i plotë i kryetarit është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi hapi diskutimin për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në lidhje me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës diskutuan: Hatim Baxhaku, në emër të Komisionit Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale; Fadil Beka, në emër të GP të PDK-së; Salih Morina, në emër të GP të LDK-së; Rexhep Selimi, në emër të GP të LVV-së; Daut Haradinaj, në emër të GP të AAK-së; Enver Hoti, në emër të GP të PDK-së; Duda Balje, në emër të GP "6+", si dhe deputetët: Ismet Beqiri, Selvi Halimi, Faton Topalli, Rustem Berisha, Anton Quni, Mexhide Mjaku-Topalli, Armend Zemaj, Aida Dërguti, Adem Salihaj, Elmi Reçica, Haxhi Shala, Albin Kurti, Adem Grabovci, Nuredin Ibishi, Shukrije Bytyqi, Bekim Haxhiu, Milazim Haliti, Shukri Buja, Muhamet Mustafa, Gëzim Kelmendi, Ismajl Kurteshi, Qerim Bajrami dhe Besa Gaxheri, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 58  
Kundër ----- 0  
Abstenime -----4

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

## V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-141 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

2. Kuvendi i ngarkoi këto komisione:

- Komisionin Funkcional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale,
- Komisionin për Buxhet dhe Financa,
- Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit,
- Komisionin për Integritet Evropian dhe
- Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim.

3. Komisionet e lartshënuara projektligjin duhet ta shqyrtojnë në pajtim me vendimin e Kuvendit nr.05-V-407, datë 30.12.2016 dhe Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime.

### **2. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e kryetarit në Komisionin për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale**

Kryetari i GP të PDK-së, Zenun Pajaziti, paraqiti propozimin e grupit për zëvendësimin e kryetarit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Kuvendi, me shumicë absolute, mori këtë:

## V E N D I M

Deputeti Nehat Baftiu emërohet kryetar i Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në vend të deputetes Flora Brovina.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së jashtëzakonshme në orën 18:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi:  
Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale*